



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politik dhe Financa
01Nr 06-39490 /21
Klinë: 15.09.2021

PËR: Kuvendin e Komunës Klinë

Nga: Komiteti për Politik dhe Financa

Kryesuesi Komitetit Fadil Gashi



REKOMANDIMET: e Komitetit për Politik dhe Financa të datës 14.09.2021

Pika 1. Shqyrtimi i Draft-buxhetit 2022-2024 për Komunën e Klinës

-Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës referoj z. Aziz Desku, drejtor për Financa Ekonomi dhe Zhvillim, theksoj se Buxheti për vitin 2022 do të jetë 11,333,332 euro, për vitin 2023- 12,071,965 euro dhe për vitin 2024- 12,650,516 euro. Po ashtu prezantoj me radhë kategoritë: Paga dhe Mëditje: viti 2022- 6,460,889 euro, për vitin 2023- 6,493,193 euro dhe për vitin 2024- 6,525,659 euro. Mallra dhe shërbime për vitin 2022 parashihen 1,308,064 euro, për vitin 2023- 1,351,526 euro dhe për vitin 2024- 1,367,882 euro. Komunalit: viti 2022- 167.000 euro, viti 2023- 171,312 euro dhe viti 2024- 178,165 euro.

-Transfere dhe Subvencione: viti 2022- 350,000 euro, viti 2023- 379,296 euro dhe viti 2023- 405,758 euro, ndërsa investime kapitale parashihen për vitin 2022- 3,047,380 euro, për vitin 2023- 3,676,638 euro dhe për vitin 2024- 4,173,052 euro.

Propozimet:

- U propozua që të ndahet një shumë prej 200.000 euro për kulturë rini dhe sport.
- Gjithashtu u propozua që tek projektet me prioritet për vitin 2022, tek projekti nr. 17 të hiqen 30.000 euro dhe të barten tek projekti nr.5.
- Po ashtu u kërkua që të ndahet një buxhet gjinorë.

- Pas shqyrtimit të Draft-buxhetit për vitin 2022-2024, Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që draft-buxheti të kaloj për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 2. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i parë me qytetarë i mbajtur nga kryetari i Komunës

-Komiteti për Politik dhe Financa, pa ndonjë rekomandim apo vërejtje, rekomandoj që procesverbali të kaloj për shqyrtim në Kuvend.

Pika 3. Shqyrtim i propozim-vendimit nga drejtorja e financave për transfer të mjeteve

Lidhur me këtë pik të rendit të ditës, z. Aziz Desku theksoj se Nga programi Shëndetësi dhe mirëqenje sociale (730), nga nen-programi Shërbimet e shëndetësisë primare (74050), kodi funksional (0721) nga Projekti "Ndërtim i shtëpisë për te moshuar", kodi i projektit 46931 shuma prej 15,000.00 € të transferohet: Në Programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660), nen-programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620) në Projektin "Bashkëfinancim me donatorë".

Komiteti për politik dhe financa, rekomandoj që kërkesa nga drejtorja për F.E.ZH, për bartje të mjeteve financiare të kaloj për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i draft-statutit për ndërmarrjen publike, lokale stacioni i autobusëve Klinë.

-Sa i përket kësaj pike referoi drejtori i Shërbimeve Publike z. Iber Elezaj i cili theksoi se bazën ligjore e ka tek ndërmarrjet publike si dhe përpilimi i tije është bërë duke u bazuar edhe në statutet e komunave të cilat i kanë të miratuara tashmë.

Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që draft-statuti për ndërmarrjen publike, lokale stacioni i autobusëve Klinë, të kaloj në Kuvend dhe të merret vendim për shqyrtim publik.

Pika 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin korrik-gusht 2021

Kërkesa 1:

Kërkesë nga drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, që pas shqyrtimit me publikun të rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend Draft-Rregullorja për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit, pronën e paluajtshme të Komunës.

Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që Draft-Rregullorja për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit pronën e paluajtshme të Komunës, të kaloj për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Kërkesa 2:

Kërkesë e parashtruar nga znj. Igballe Krasniqi, edukatore në kopshtin e fëmijëve "Xheve Lladrovci" në Klinë e cila thekson se vuan nga një sëmundje e rënd dhe kërkon mbështetje financiare.

-Pas shqyrtimit të kërkesës, Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që kërkesa e znj. Igballe Krasniqi të kaloj për shqyrtim në Kuvend dhe ti ndahet një shumë e mjeteve financiare prej 1500 euro.

Kërkesa 3:

Kërkesë nga banoret e rrugës “Skender Rexhepi” të cilët kërkojnë nga Komuna e Klinës që kjo rrugë të rikthehet në rrugë një kahje ashtu siç ka qenë me parë, pasi që kjo rrugë nuk i plotëson kushtet për rrugë në dy kahje.

Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që kërkesa e banoreve të rrugës “Skender Rexhepi” të shqyrtohet nga drejtorit përkatëse të cilat janë kompetente, ato do ta shqyrtojnë kërkesën dhe do t’a vlerësojnë situatën, varësisht nga vlerësimi, do të merret vendimi.

Kërkesa 4:

Kërkesë e parashtruar nga Naim Bullaku nga fshati Jashanic e Eperme për kompensimin e dëmit i cili ka ndodhur me rastin e ngordhjes së 100 krerëve dele nga sëmundja infektive.

Pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Naim Bullaku. Komiteti për Politik dhe Financa rekomandoj që kërkesa të kaloj për shqyrtim në Kuvend dhe z. Bullaku, ti ndahet një shumë prej 2000 euro me mundësi të ngritjes së vlerës në 3000 euro, varësisht nga mundësia buxhetore.